



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 2.6.2023

Nr: 654

Ora: 09:30

VENDIM

PËR

**SHPËRNDARJEN E MANDATEVE NDËRMJET SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË
MEMALIAJ, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, nenet 162 dhe 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

VËREN:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “i”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve miraton shpërndarjen e mandateve në zgjedhjet për këshillat vendorë, si dhe jep mandatet për çdo kryetar bashkie, territori i të cilave është ndarë në më shumë se një ZAZ.

Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, me vendimin nr. 260, datë 16.5.2023, ka miratuar Tabelën Përmbledhëse të Rezultatit për Këshillin e Bashkisë Memaliaj. Kundër këtij vendimi është administruar kërkesa ankimore nr. 69, datë 22.05.2023, depozituar nga z. Naçi Lato, kandidat për këshill bashkiak, për subjektin zgjedhor “Fryma e Re Demokratike”, Bashkia Memaliaj, me objekt pavlefshmërinë e tabelave përmbledhëse për të gjitha QV-të e KZAZ nr. 78, Bashkia Memaliaj dhe rinumërim të kutive të votimit për këshillin bashkiak.

Në seancën paraprake të datës 23.05.2023, ora 13:40, KAS konstatoi se kjo kërkesë ankimore ishte me të meta pasi nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126 të Kodit Zgjedhor, duke vendosur kthimin për plotësim të elementeve të formës, me një afat 24 orë, si dhe zhvillimin e seancës paraprake më datë 24.05.2023, ora 14:30.

Më datë 24.05.2023, në seancë publike KAS shqyrtoi kërkesën ankimore, në përfundim të së cilës vendosi:

- Pushimin e shqyrtimit të kërkesës ankimore nr. 69, datë 22.05.2023 të depozituar nga z. Naçi Lato.

Data: 2.6.2023 Nr: 654
Ora: 09:30



“Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Memaliaj, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

Është administruar edhe kërkesa ankimore nr. 72, datë 22.05.2023, depozituar nga z. Lame Jaupaj, kandidat për këshill bashkiak, për subjektin zgjedhor “Aleanca Progresiste LZHK”, Bashkia Memaliaj, me objekt rinumërimin e kutive të këshillit bashkiak për KZAZ nr. 78, Memaliaj.

Në seancën paraprake të datës 23.05.2023, ora 14:05, KAS konstatoi se kjo kërkesë ankimore ishte me të meta pasi nuk i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126 të Kodit Zgjedhor, duke vendosur kthimin për plotësim të elementeve të formës, me një afat 24 orë, si dhe zhvillimin e seancës paraprake më datë 24.05.2023, ora 14:45.

Më datë 24.05.2023, në seancë publike KAS shqyrtoi kërkesën ankimore, në përfundim të së cilës vendosi:

- Pushimin e shqyrtimit të kërkesës ankimore nr. 72, datë 22.05.2023 të depozituar nga z. Lame Jaupaj.

Në bazë të nenit 162, pika 1, dhe 166, pika 3, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve përllogarit shpërndarjen e mandateve për çdo zonë zgjedhore.

Rezultati për Këshillin e Bashkisë Memaliaj për subjektet zgjedhore pasqyrohet në tabelën nr. 1 në vijim.

(Tabela nr. 1)

Nr. FV	Subjekti Zgjedhor	Vota	Përqindja
1	Bashkë Fitojmë	948	16,72 %
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	2024	35,69 %
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	291	5,13 %
4	Partia Republikane Shqiptare	115	2,03 %
5	Partia Lëvizja e Legalitetit	60	1,06 %
6	Partia Demokracia Sociale	281	4,96 %
8	Partia Socialdemokrate	455	8,02 %
9	Partia Demokratike	584	10,30 %
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	170	3,00 %
11	Fryma e Re Demokratike	161	2,84 %
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	73	1,29 %
18	Partia Balli Kombëtar	213	3,76 %
19	Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	132	2,33 %
23	Partia e Gjelbër	164	2,89 %
	Totali	5671	100 %

Në bazë të nenit 162, pika 2, numri i votave të vlefshme në nivel zone zgjedhore të secilit subjekt pjesëtohet në mënyrë të vazhdueshme me numra natyrorë të njëpasnjëshëm, të quajtur pjesëtues, duke filluar me numrin 1 dhe duke përfunduar me numrin natyror 15 (pesëmbëdhjetë) që i

korrespondon numrit të mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore Bashkia Memaliaj, në bazë të shkresës me nr. 198/1 Prot, datë 27.02.2023, të Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Herësit e përfutur nga ky pjesëtim pasqyrohen në tabelën nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Sipas nenit 162, pika 4, herësit e përfutur nga çdo pjesëtim, renditen në listë nga herësi më i madh tek ai më i vogël, duke renditur përkrah tyre subjektin, të cilit i përket herësi përkatës. Renditja vazhdon derisa të renditen aq herës sa është numri i mandateve që shpërndahen në zonën zgjedhore përkatëse, pra 15 (pesëmbëdhjetë). Nga kjo renditje marrim rezultatin e pasqyruar në tabelën nr. 3, në vijim.

(Tabela nr. 3)

Nr.	Herësi	Subjekti
1	2024	Partia Socialiste e Shqipërisë
2	1012	Partia Socialiste e Shqipërisë
3	948	Bashkë Fitojmë
4	674	Partia Socialiste e Shqipërisë
5	584	Partia Demokratike
6	506	Partia Socialiste e Shqipërisë
7	474	Bashkë Fitojmë
8	455	Partia Socialdemokrate
9	404	Partia Socialiste e Shqipërisë
10	337	Partia Socialiste e Shqipërisë
11	316	Bashkë Fitojmë
12	292	Partia Demokratike
13	291	Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë
14	289	Partia Socialiste e Shqipërisë
15	281	Partia Demokracia Sociale

Në bazë të nenit 162, pika 5, të Kodit Zgjedhor, një subjekt zgjedhor përfiton një numër mandatesh të barabartë me numrin e herësve të përfshirë në listën e përcaktuar më sipër.

Nga kryerja e veprimeve të mësipërme marrim rezultatin për shpërndarjen e mandateve të pasqyruar në tabelën nr. 4, në vijim.

(Tabela nr. 4)

Nr.	Subjekti Zgjedhor	Mandate
1	Bashkë Fitojmë	3
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	7
3	Partia Agrare Ambjentaliste e Shqipërisë	1
4	Partia Demokracia Sociale	1
5	Partia Socialdemokrate	1
6	Partia Demokratike	2

Data: 2.6.2023 Nr: 654
Ora: 09:30



"Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore për Këshillin e Bashkisë Memaliaj, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023"

Sipas nenit 163, pika 1 dhe të nenit 166, pika 3, të Kodit Zgjedhor, menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit si më sipër, KQZ-ja përllëgarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt, në bazë të renditjes në listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore të miratuara nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “i”, e 2, nenet 162 dhe 166, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOS:

1. Shpërndarjen e mandateve për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Bashkia Memaliaj, si më poshtë:

Subjekti Zgjedhor	Mandate
Bashkë Fitojmë	3
Partia Socialiste e Shqipërisë	7
Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	1
Partia Demokracia Sociale	1
Partia Socialdemokrate	1
Partia Demokratike	2

2. Shpalljen e kandidatëve fitues nga listat shumëmemërore të subjekteve zgjedhore, të miratuara nga Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, për Këshillin e Bashkisë Memaliaj, si më poshtë:

Bashkë Fitojmë

1	Bujar	Pasho	Kapllani
2	Maltona	Hysen	Bërxihi
3	Aristotel	Yzeir	Malka

Partia Socialiste e Shqipërisë

1	Asqeri	Hasan	Muçoima
2	Edmonda	Kalo	Harizi
3	Erjon	Bino	Sinanaj
4	Afize	Agur	Sula

5	Anest	Tajar	Halili
6	Irena	Alem	Jaupi
7	Taulant	Novrus	Rama

Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë

1	Xhevit	Nuri	Kacorri
---	--------	------	---------

Partia Demokracia Sociale

1	Petrit	Yzeir	Lumani
---	--------	-------	--------

Partia Socialdemokrate

1	Bujar	Xhevit	Mamaj
---	-------	--------	-------

Partia Demokratike

1	Esmerald	Luan	Xhemali
2	Arsola	Thimjo	Muzha

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Bashkia Memaliaj, herësit

Tabela nr. 2

NR_FV	SUBJEKTI	SIGLA	1	2	3	4	5	6	7	
1	Bashkë Fitojmë	BF	948	474	316	237	189	158	135	H e r ë s i t
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	PS	2024	1012	674	506	404	337	289	
3	Partia Agrare Ambientaliste e Shqipërisë	P.A.A	291	145	97	72	58	48	41	
4	Partia Republikane Shqiptare	PR	115	57	38	28	23	19	16	
5	Partia Levizja e Legalitetit	PLL	60	30	20	15	12	10	8	
6	Partia Demokracia Sociale	P.D.S	281	140	93	70	56	46	40	
8	Partia Socialdemokrate	PSD	455	227	151	113	91	75	65	
9	Partia Demokratike	PDSH	584	292	194	146	116	97	83	
10	Aleanca Progresiste L.ZH.K	LZHK	170	85	56	42	34	28	24	
11	Fryma e Re Demokratike	FRD	161	80	53	40	32	26	23	
12	Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	P.D.I.U	73	36	24	18	14	12	10	
18	Partia Balli Kombëtar	P.B.K	213	106	71	53	42	35	30	
19	Aleanca për Demokraci dhe Solidaritet	ADS	132	66	44	33	26	22	18	
23	Partia e Gjellbër	P.GJ	164	82	54	41	32	27	23	